

KOMUNA RAHOVEC

2020



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC

KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINETI I PRESEDIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)

Nr./Br./No 431/20 Nr. i faq/Br.str/No.pg 44

Data/Datum/Date 10/04/2020

RAHOVEC / ORAHOVAC

RAPORT TREMUJOR I PUNËS - NJËSIA E PERSONELIT

JANAR- MARS 2020

Zyra e Burimeve Njerëzore - Njësia e Personelit

Rekrutimet

Gjatë kësaj periudhe janë shpallur 2 konkurse, për angazhim të stafit me Marrëveshje për Shërbime të Veçanta, janë pranuar në punë 28 punëtor me MVSH, për kohëzgjatje më pak se 6 muaj.

Pushimet vjetore

Një pjesë e punonjësve të Administratës Komunale në Rahovec kanë filluar të shfrytëzojnë pushimin vjetor për vitin 2020.

Lëshimi i akteve administrative

Njësia e Personelit gjatë kësaj periudhe ka lëshuar 28 Marrëveshje për Shërbime të Veçanta për punëtorët e rinj, poashtu, janë lëshuar 65 shkresa të ndryshme administrative.

Tabelat statistikore

Të dhënat statistikore të personelit, Njësia e personelit i procedon drejtpërdrejtë në programin elektronik SIMBNJ, sipas kërkesës së MAP/DASHC-së, që bëhet rregullisht. Njësia e personelit të dhënat statistikore për sektorët e arsimit dhe shëndetësisë i siguron nga zyrtarët e atyre dy sektorëve.

Komisioni Disiplinor

Në Komisionin Disiplinor nuk ka pasur asnjë lëndë disiplinore.

Vijueshmëria e punëtorëve në punë

Funksionon Sistemi i Mbikëqyrjes së Vijueshmërisë së punëtorëve në punë-SMVP, u janë dërguar drejtorive raportet e vijueshmërisë së punëtorëve për çdo muaj: janar, shkurt dhe mars 2020.

Plani individual i personelit

Njësia e personelit ka hartuar Planin Individual të Personelit të Komunës së Rahovecit për vitin 2020 dhe është hartuar në mënyrë elektronike sipas programit SIMBNJ.

Administrimi i programeve elektronike

Njësia e Personelit menaxhon dhe monitoron disa programe elektronike që kanë të bëjnë me burimet njerëzore si në vijim:

- Menaxhon me programin elektronik SIMBNJ që dmth. Sistemi i Informacionit për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore.
- Monitoron sistemin e prezencës (vijueshmërisë) në punë të punëtorëve, pra, programin SMVP.
- Menaxhon (një pjesë) me programin SMAED që në nivel shtetëror është kompetent ASHI-Agjencioni i Shoqërisë së Informacionit/MAP.
- Monitoron me programin elektronik PYROLL, pra programit të listave, pagave dhe pagesave të komunës

Rahovec, 8 prill 2020